



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Panoramë e Eko-Sistemit të Sipërmarrjeve Sociale në Shqipëri

2019

www.partnersalbania.org

Eko-Sistemi i Sipërmarrjeve Sociale në Shqipëri

© 2019 by Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Ky publikim u përgatit me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian nëpërmjet Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Tabela e Përmbajtjes

Hyrje	4
Format ekzistuese të NSve në Shqipëri	5
Kuadri ligjor për ndërmarrjet sociale.....	9
Mekanizmat mbështetës për sipërmarrjen sociale.....	10
Sfidat e veprimtarisë së sektorit të sipërmarrjes sociale.....	14
Rekomandime	15
Referenca.....	17

Hyrje

Sipërmarrja sociale është një nga proceset më të diskutuara në Evropë, si një model inovator që mund të zgjidhë një seri çështjesh të mprehta sociale dhe ekonomike si papunësia, varfëria, pabarazia, përjashtimi social, etj.

Sipërmarrja sociale shihet si modeli i biznesit të shekullit të 21, i cili balancon nevojat financiare, sociale, kulturore dhe mjedisore. Sipërmarrësit social janë agjentë ndryshimi si individë dhe grupe pasionante për të përmirësuar jetën e njerëzve dhe komuniteteve. Në një kohë krize ekonomike, sfidash të një popullsie në plakje, papunësie rinore, ndryshimesh klimatike, sipërmarrja sociale shihet si një mundësi optimale për zhvillimin e ekonomisë sociale.

Përkufizimi operacional i Bashkimit Evropian bazohet në Iniciativën e Biznesit Social (SBI) 2011.¹ Sipas tyre, një sipërmarrje sociale është një operator në ekonominë sociale, i cili ka disa karakteristika specifike:

- ✓ *Ka si qëllim primar arritjen e një impakti social më tepër se gjenerimin e fitimit për pronarët dhe aksionerët;*
- ✓ *E përdor bilancin pozitiv kryesisht për të arritur qëllimin social;*
- ✓ *Manaxhohet në mënyrë të përgjegjshme, transparente dhe inovative, në veçanti duke përfshirë punonjës, klientë dhe grupe interesi të ndikuar nga aktiviteti i biznesit.*

Ky përkufizim e kuadron sipërmarrjen sociale në tre dimensione (Komisioni Evropian, 2015):

- **Dimensioni sipërmarrës** – sipërmarrjet sociale janë të angazhuara në realizimin e aktiviteteve ekonomike të qëndrueshme dhe të vazhdueshme;
- **Dimensioni social** – sipërmarrjet sociale ndjekin qëllimin social duke i shërbyer komunitetit ose një grupi specifik njerëzish që ka një nevojë specifike duke ofruar shërbime në fushën e shëndetit, mjedisit, kulturës dhe edukimit apo ofrimin e produkteve që kanë një domethënie sociale;
- **Dimensioni i lidhur me strukturën e qeverisjes** – identifikimi i nevojave dhe përfshirja e grupeve të interesit duke ofruar zgjidhje inovative, sipërmarrjet sociale kërkojnë struktura pronësie dhe modele qeverisëse specifike që janë të predispozuar të përfshijnë grupet e interesit të ndikuara nga sipërmarrja sociale. Sipërmarrjet sociale në mënyrë eksplicite ndalojnë shpërndarjen e fitimeve tërësisht të pronarët dhe kanë një procedurë për bllokimin e aseteve. Parimi i mosshpërndarjes së fitimit garanton sigurinë e interesit të përgjithshëm. Fitimi mund të përdoret në forma të ndryshme si riinvestimi, fond rezervë, shpërblime për punonjësit etj.

¹ COM (2011) 682 final – Iniciativa e Biznesit Social: Krijimi i një klime të favorshme për ndërmarrjet sociale, aktorët kyç në ekonominë sociale dhe inovacion. Url:<http://ec.europa.eu/transparency/regdoc/rep/1/2011/EN/1-2011-682-EN-F1-1.Pdf>

Format ekzistuese të NSve në Shqipëri

Si një pjesë e madhe e vendeve Ballkanike, gjurmët e para të sipërmarrjes sociale i takojnë periudhës së regjimit komunist në Shqipëri. Forma përfaqësuese ishin kooperativat, të cilat operonin në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë. Të gjithë pronarët privatë u shpronësuan me ardhjen e regjimit komunist, çka bëri që fermerët në kooperativa mos të zotëronin asgjë në terma të tokës, kapitalit, mjeteve të prodhimit apo produkteve që prodhonin. Krahu i punës paguhej shumë pak. Rrjedhimisht, kooperativat pas viteve 90' kanë shumë pak ngjashmëri përsa i përket shpirtit sipërmarrës, qeverisjes demokratike e me pjesëmarrje. Ekonomia e lire e tregut përcaktoi rregulla të reja ndryshe nga regjimi i kaluar.

Dy dekadat e fundit, pjesa më e madhe e sipërmarrjeve sociale janë krijuar nga organizata jofitimprurëse (OJF-të) me mbështetjen e donatorëve të huaj, të cilat janë iniciuar si projekte me një kohëzgjatje të caktuar, ku një pjesë e mirë kanë përfunduar pas mbarimit të projektit.

Në Shqipëri nuk ekziston një përkufizim i pranuar gjerësisht në sektor, si dhe në publik mbi sipërmarrjen sociale. Kjo e bën thuajse të pamundur të përcaktosh numrin ekzakt të sipërmarrjeve sociale që funksionojnë në vend. Megjithatë ka disa forma kryesore ligjore që funksionojnë bazuar nëparimet e sipërmarrjes sociale:

a) **organizatat jofitimprurëse** (*shoqata, fondacionet dhe qendrat*);

b) kompanitë (*në formën e biznesit të vogël apo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar*),

c) **kooperativat** (*Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor*);

d) **shoqata të kursim-kreditit**.

Bazuar në formën e organizimit ka **3 forma** që organizatat jofitimprurëse mund të regjistrohen: **shoqata** (*me anëtarësi që u shërbejnë kryesisht anëtarëve të tyre*), **qendrat dhe fondacionet** (*pa anëtarësi që u shërbejnë interesit publik*) bazuar në Ligjin Nr. 8788/2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse"² dhe dy amendamentet e fundit shtesë në 2007³ dhe në 2013,⁴ si dhe në Ligjin Nr. 8789/2001 "Për regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse".⁵

Qendra dhe Fondacioni kanë një funksionim të ndryshëm përsa i përket organizimit dhe qeverisjes nga shoqata duke qenë se janë pa anëtarësi dhe kanë si organin më të lartë vendimmarrës Bordin e Drejtorëve. Ndërkohë organi më i lartë vendimarrës i shoqatave është Asambleja e Përgjithshme.

²Ligji Nr. 8788 "Për Organizatat Jofitimprurëse", datë 7.5.2001. Linku: http://www.akdie.org/sites/default/files/ligj_per_ojf.pdf

³Ligji Nr. 9814 "Për disa shtesa dhe amendime në Ligjin Nr. 8788, datë 7.5.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse", 4 Tetor 2007. Linku:

http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2007/PDF-2007/138-2007.pdf

⁴Ligji Nr. 92 "Për disa shtesa dhe amendime në Ligjin Nr. 8788, datë 7.5.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse", 28 Shkurt 2013. Linku: http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2013/PDF-2013/36-2013.pdf

⁵Ligji Nr. 8789/2001 "Për Regjistrimin e OJFve", 7 Maj 2001. Linku: http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2001/PDF-2001/28-2001.pdf

Një organizatë jofitimprurëse mund të kryejë aktivitet ekonomik pa pasur nevojë për krijimin e një entiteti të veçantë në kushtet kur aktiviteti është në përputhje me misionin dhe nuk prevalon mbi aktivitetin jo ekonomik. Fitimet duhet të përdoren për qëllimet e specifikuar në aktin e themelimit dhe statutin e organizatës. Që një organizatë jofitimprurëse të përfitojë nga përjashtimi tatimor duhet që aktiviteti ekonomik mos të tejkalojë **20%** të të ardhurave totale vjetore të organizatës. Të gjitha organizatat jofitimprurëse e kanë të shprehur në mënyrë eksplicite qëllimin social në misionin dhe statutin e organizatës.

Bazuar në të dhënat e marra nga Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve (2018), **679** organizata (shoqata, fondacione, qendra) ushtrojnë aktivitet ekonomik.⁶ Ndërkohë, sipas Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), **319** organizata jofitimprurëse disponojnë një liçencë për të ofruar shërbime edukative dhe sociale.⁷

Nga një studim i fundit vihet re se organizatat jofitimprurëse të reja (**1-6** vjet) përfshihen në shërbime me pagesë që gjenerojnë të ardhura që në fillimet e krijimit të tyre, çka tregon nevojën e sektorit për tu diversifikuar dhe trendin rritës të krijimit të ndërmarrjeve sociale. Ka dhe organizata nga **14** deri në **16** vjet në sektorin e shoqërisë civile që kanë eksperiencë të gjatë në ofrimin e shërbimeve me pagesë. Përsa i përket

⁶Të dhëna të marra përmes kërkesës për Informacion adresuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Shtator 2018

⁷Të dhëna të marra përmes kërkesës për Informacion adresuar Qendrës Kombëtare të Biznesit, Shtator 2018

shpërndarjes gjeografike, këto organizata në përgjithësi janë të përqëndruara në rajonin e Tiranës. Lloji i shërbimeve me pagesë varion nga *shërbimet sociale, shërbimet mjekësore (analiza laboratorike), trajnime dhe konsulencë për çështjet ligjore dhe të marketingut, monetarizimi i aseteve⁸, etj.* Shërbimet me pagesë adresojnë një shumëllojshmëri klientësh, që variojnë nga *publiku i gjerë, nxënësit, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuar, mësuesit, bizneset, partitë politike, bashkitë, instucionet ndërkombëtare* (Partnerët Shqipëri, 2018).

Arsyet kryesore pse organizatat jofitimprurëse angazhohen në shërbime me pagesë janë:

➡ *nevoja për të rritur qendrueshmërinë financiare;*

➡ *përvoja e gjatë e veprimtarisë në një fushë të caktuar;*

➡ *ndikimi nga praktikat më të mira në vendet e tjera;*

➡ *disponueshmëria e aseteve apo burimeve kyç në fushën ku operojnë,*

çka u jep një avantazh konkurrues kundrejt të tjerëve (Partnerët Shqipëri, 2018).

Së dyti, kompanitë që zbatojnë parimet e sipërmarrjes sociale konsistojnë në biznese të vogla ose shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Bizneset duhet të regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit me qëllim marrjen e statusit ligjor. Një pjesë e këtyre bizneseve janë themeluar

⁸Monetarizimi i Aseteve konsiston në gjenerimin e të ardhurave përmes dhënies me qera të hapësirave/mjeteve të klientë të ndryshëm (Dhënia me qera e një zyre për realizimin e një trajnimit).

nga organizata jofitimprurëse dhe janë në pronësi të tyre, çka mundëson respektimin e parimit të qeverisjes me pjesëmarrje dhe llogaridhënies në mënyrën e funksionimit të biznesit. Pjesa tjetër e bizneseve kanë një ose më shumë pronarë, të cilët janë vendimmarrësit e vetëm, duke mos e aplikuar parimin e qeverisjes demokratike. Përsa i

Ndërkohë, forma tjetër ligjore janë kooperativat të rregulluara nga Ligji Nr. 38/2012 “Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor”.⁹ Ky ligj bazohet në një kuadër ligjor më të gjerë si Ligji Nr. 8088/1996 “Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Reciprok”,¹⁰ dhe dy amendamente të realizuara në 2003¹¹ dhe 2007.¹² Kooperativat kanë mundësinë të bashkohen dhe të krijojnë federata të kooperativave me qëllim mbrojtjen dhe promovimin e një interesi më të gjerë të shumë fermerëve, të cilët punojnë në zona rurale dhe kryejnë aktivitetet ekonomik në fushën bujqësore.

⁹Ligji Nr. 38/2012 “Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor”, 5 Prill 2012. Linku: http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2012/PDF-2012/42-2012.pdf

¹⁰Ligji Nr. 8088 “Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Reciprok”, 21 Mars 1996, Linku: http://www.vendime.al/wp-content/uploads/2015/07/Ligj_Nr.8088_date_21.03.1996_Per_shoqerite_e_bashkepunimit_reciprok_941047.pdf

¹¹Ligji Nr. 9039/2003 “Për disa shtesa dhe amendime në Ligjin Nr. 8088 datë 21.03.1996 Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Reciprok”, 27 Mars 2003.

¹²Ligji Nr. 9747 “Për disa shtesa dhe amendime në Ligjin Nr. 8088 datë 21.03.1996 Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Reciprok”, 31 Maj 2007.

përket qëllimit social, pjesa më e madhe e bizneseve nuk e kanë të formalizuar në ekstraktin e QKB-së, por në përgjithësi e bëjnë publik në faqet e tyre të website.

Shoqëritë e Bashkëpunimit reciprok janë formacione të ngjashme me kooperativat bujqësore që operojnë në fusha të ndryshme të aktivitetit ekonomik, por shihen si një formë ligjore e përshtatshme për sektorin e kreditimit, sigurimit dhe ndërtimit (Partnerët Shqipëri, 2016). Ka **106 kooperativa** të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit, nga të cilat **67** kanë një status aktiv.¹³ Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor *janë të përjashtuara nga tatim fitimi*.

¹³Të dhëna të marra përmes Kërkesës për Informacion adresuar Qendrës Kombëtare të Biznesit, Shtator 2018

Një formë tjetër që aplikon parimet e sipërmarrjes sociale në Shqipëri janë **Shoqëritë e Kursim-Kreditit (SHKK)** e krijuar bazuar në Ligjin e ri Nr. 52/2016 “Për Shoqëritë e Kursim-Kreditit dhe Unionet e tyre”. SHKK-të funksionojnë bazuar në organizimin vullnetar të anëtarëve, të cilët depozitojnë paratë e tyre në shoqëri, për t’u përdorur për dhënie kredie vetëm te anëtarëte shoqërisë së kursim-kreditit, me qëllim përmbushjen e nevojave apo interesave të anëtarëve. Numri minimal i anëtarëve të nevojshëm për krijimin e SHKK-së duhet të jetë jo më pak se **50**. Në përfundim të vitit të dytë të ushtrimit të aktivitetit nga SHKK-ja, si dhe në periudhën vijuese, numri i anëtarëve duhet të jetë jo më pak se **200 anëtarë**.¹⁴ Në vitin 2002 është krijuar dhe Unioni i Shoqërive të Kursim Kreditit i cili manaxhohet nga anëtarët e SHKKve. Sipas Bankës së Shqipërisë, në vend janë liçensuar **13 SHKK** dhe **1 union**.¹⁵ Shoqëritë e Kursim Kreditit *janë të përjashtuara nga tatim fitimi*.

Pjesa më e madhe e NS-ve (**60%**) janë themeluar gjatë 2009-2014, dhe **70% e NS-ve kanë deri në 5 punonjës me kohë të plotë**. Ato angazhohen në aktivitete të ndryshme, kryesisht *në bujqësi, arsim, shërbime sociale* ndaj njerëzve në nevojë, dhe *trajtime profesionale* në fusha të ndryshme. Shitjet

ndaj klientëve privat dhe publik përbëjnë llojin kryesor të të ardhurave ndjekur nga të ardhurat e aktivitetit filantropik dhe ato nga investimet (Partnerët Shqipëri, 2016).

¹⁴Ligji Nr. 56/2016 “Për Shoqëritë e Kursim Kreditit dhe Unionet e tyre” datë 19.5.2016

Linku:https://www.bankofalbania.org/rc/doc/Ligj_52_2016_Per_s_hoqerite_e_kursim_kreditit_dhe_unionet_e_tyre_7747_1_6239.pdf

¹⁵Url:https://www.bankofalbania.org/Mbikeqyrja/Subjekte_te_lice_ncuara/Shoqeri_te_kursim_kreditit_dhe_unionet_e_SHKK-ve/

Kuadri ligjor për ndërmarrjet sociale

Përpjekjet për të hartuar një ligj për sipërmarrjen sociale kanë nisur që në 2010 nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (tashmë Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale). Në 2016, qeveria shqiptare miratoi Ligjin 65/2016 “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë”.¹⁶

Gjatë një periudhe prej dy vjetësh e gjysëm është plotësuar paketa ligjore përkatësisht me udhëzimin “Për procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e statusit të ndërmarrjes sociale”,¹⁷ Vendimin “Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së kontrollit të veprimtarisë së ndërmarrjes sociale”,¹⁸ Vendimin “Për krijimin e fondit në mbështetje të ndërmarrjeve sociale dhe format e mbështetjes

nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale,¹⁹ Vendimin “Për miratimin e listës së veprimtarive që ushtrojnë ndërmarrjet sociale”²⁰, Vendimin “Për përcaktimin e kategorive konkrete të grupeve të pafavorizuara”.²¹ *Ende ky ligj nuk është i zbatueshëm dhe asnjë organizatë jofitimprurëse nuk ka marrë statusin e ndërmarrjes sociale.* Pasi aktet nënligjore janë publikuar, ende mungojnë udhëzime të cilat janë parashikuar në ligj.

Ligji i përcakton ndërmarrjet sociale në mënyrë eksplicite si një *model për integrimin në punë të grupeve të marginalizuara*. Bazuar në këtë ligj, statusin mund ta marrin vetëm organizatat jofitimprurëse që ofrojnë të mira dhe shërbime në përputhje me nevojat e komunitetit në *sektorin e shërbimeve shoqërore, shëndetësore, kulturore e arsimore, të promovimit të turizmit e mbrojtjes mjedisore, ndërmjetësimit e kualifikimit për punësim, punësimit rinor.*

¹⁶Ligji Nr. 65/2016 “Për Ndërmarrjes Sociale në Republikën e Shqipërisë”, datë 9 qershor 2016.

Linku:http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PDF-2016/118-2016.pdf

¹⁷Udhëzim Nr. 602/2018 “Për procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e statusit të ndërmarrjes sociale”, datë 1.8.2018, Linku:

<http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%20121/UDHEZIM%20nr.%20602,%20date%201.8.2018.pdf>

¹⁸Vendim Nr. 76/2017 “Për Përcaktimin e procedurave të kryerjes së kontrollit të veprimtarisë së ndërmarrjes sociale”, datë 1.12.2018. Linku:

http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2017/PDF-2017/218-2017.pdf

¹⁹Vendim Nr. 789/ 2018 “Për krijimin e fondit në mbështetje të ndërmarrjeve sociale dhe format e mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale”, datë 26.12.2018 Link: <http://www.botimezyrtare.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%20192/VKM%20nr.%20789,%20date%2026.12.2018.pdf>

²⁰Vendim Nr. 16/2018 “Për miratimin e listës së veprimtarive që ushtrojnë ndërmarrjet sociale”, datë 12.1.2018.

Link:<http://qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%203/VKM%20nr.%2016,%20date%2012.1.2018.pdf>

²¹Vendim Nr. 56/2018 “Për përcaktimin e kategorive konkrete të grupeve të pafavorizuara”, datë 31.1.2018. Link:<http://qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%2015/VKM%20nr.%2056,%20date%2031.1.2018.pdf>

Ligji përcakton që fitimet duhet të shpërndahen me qëllim zgjerimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e ndërmarrjes sociale si dhe vendos disa kriterë ekonomike dhe sociale për të marrë statusin e ndërmarrjes sociale. Të paktën **20%** e të ardhurave pas vitit të dytë dhe **30%** e të ardhurave pas vitit të tretë duhet të gjenerohen nga aktiviteti ekonomik. Përveç përfshirjes së vullnetarëve, ndërmarrjet sociale duhet të punësojnë të paktën **3** punonjës të paguar me

kohë të plotë. Të paktën **30%** e punonjësve duhet të punësohen nga grupet e marginalizuara.

Ndërkohë ligji parashikon një sërë penalitetesh në rast se një entitet ligjor përdor emrin “ndërmarrje sociale”, apo shkel një nga kriteret sociale dhe ekonomike (neni 23). Në rast se një ndërmarrje sociale humbet statusin, pas likuidimit të kreditorëve, pronat e krijuara gjatë kohës së mbajtjes së statusit duhet të përdoren për interes të publikut ose t’u transferohen ndërmarrjeve të tjera sociale (neni 14, pika 5).

Mekanizmat mbështetës për sipërmarrjen sociale

Duke marrë në konsideratë rëndësinë dhe debatin në rritje për sipërmarrjen sociale, kanë filluar të krijohen dhe skema të posaçme për ndërmarrjet sociale por sërisht janë shumë të pakta dhe nevojitet më shumë promovim i tyre që sektori të njihet me to.

Bashkimi Evropian është një nga donatorët e paktë që e ka ekonominë sociale pjesë të programit IPA CSF 2016-2017, ku boshti 2 i programit me një buxhet prej **400,000 EUR** (50 milion Lekë) fokusohet në promovimin e kapaciteteve të shoqërisë civile dhe mbështetjen e iniciativave në ekonominë sociale për zhvillim përfshirës.²²

Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë ka mbështetur krijimin e

²²EuropeAid/155863/DH/ACT/AL: Programi IPA përShoqërinëCiviledhe Median 2016-2017. Mbështetja e KapacitetevetëOrganizatavetëShoqërisëCivile

sipërmarrjeve sociale nga organizatat e shoqërisë civile përmes një programi 2 vjeçar me një buxhet prej **120,000 USD** (afërsisht 13 milion Lekë).

Ndërkohë Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Punësimin e Grave (UNWomen) mbështet zhvillimin e sipërmarrjes sociale përmes një fushe më të gjerë si fuqizimi ekonomik.

Partnerët Shqipëri është një nga organizatat jofitimprurëse që punon për zhvillimin e ndërmarrjeve sociale duke rritur kapacitetet e tyre të brendshme por dhe mbështetjen financiare të tyre përmes disa programeve si “Idetë e Gjelbërta”, “CAUSE” dhe së fundmi “EMBRACE”. Përmes programit “Idetë e Gjelbërta” janë mbështetur **20 sipërmarrje sociale** prej vitit 2012-2018 me një shumë prej **133,000 EUR** (afërsisht 17 milion Lekë).

Prej vitit 2016, Partnerët Shqipëri po implementon projektin CAUSE - "Përdorimi i Aseteve të Konfiskuara për Eksperimente Sociale", një projekt i financuar nga Bashkimi Europian, përmes Delegacionit të BE-së në Shqipëri, me një shumë totale dedikuar për ngritjen e **2-3 sipërmarrjeve sociale** prej **300,000 EUR** (afërsisht 38 milion Lekë). Deri tashmë është krijuar një sipërmarrje sociale në një nga pronat e konfiskuara nga krimi i organizuar, në qytetin e Fierit. Ky model do të shërbejë për të përdorur pronat e konfiskuara nga krimi i organizuar dhe vënien në shërbim të komuniteteve lokale dhe grupeve të marginalizuara duke gjeneruar të ardhura nga produkte dhe shërbime me vlerë të shtuar për shoqërinë.

Ndërkohë programi "EMBRACE" me një fond prej **101,000 EUR** (afërsisht 12,6 milion Lekë) mbështet financiarisht organizatat jofitimprurëse që synojnë të krijojnë sipërmarrje sociale.

Aktualisht janë mbështetur **5 organizata**, kryesisht në *fushën e turizmit, shërbimeve sociale, produkteve artizanale dekorative dhe ushqimore* dhe në vijim do të mbështeten dhe rreth **9 OJF** të tjera si pjesë e komponentit të nën-grantimit.

Yunus Social Business Balkans prej **3 vitesh** ka shpallur programin HapIde Combinator një partneritet me USAID prej **3.02 million EUR** (afërsisht 376 milion Lekë). Ky partneritet ka për qëllim mbështetjen e sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme, kryesisht sipërmarrjeve sociale. Sipas të dhënave, Yunus Social Business Albania ka mbështetur rreth **32 sipërmarrje sociale** me një

fond total prej **1.3million USD** (afërsisht 142 milion Lekë).²³

Ndërkohë ka disa skema të tjera shtetërore ose programe nga donatorë të huaj bilateral dhe multilateralë që mbështesin organizatat jofitimprurëse, çka ndikojnë indirekt në fuqizimin e tyre dhe krijimin potencial të iniciativave sipërmarrëse sociale.

Komisioni Europian është donatori më i madh për shoqërinë civile, i cili përmes instrumentave të ndryshëm ka kontribuar për periudhën 2009-2013 në vlerën **12,691,478.72 EUR** (afërsisht 1.6 miliard Lekë). Donatorë të tjerë bilateralë apo agjensi zhvillimi si Banka Botërore, Kombet e Bashkuara, Fondacioni i Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, apo qeveri si Danimarka, Holanda, Britania e Madhe kanë mbështetur financiarisht ndër vite shoqërinë civile (Babovic, et al., 2014).

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) është i vetmi organizëm shtetëror që mbështet OSHC-të përmes granteve. Gjatë 2010-2017 ka financuar rreth **463 projekte** të organizatave të shoqërisë civile me një buxhet total prej **840,338,840 Lekë** (rreth 6.7 million EUR) (AMSHC, 2015; AMSHC, 2016; AMSHC, 2017).

Institucione si Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Kulturës ofrojnë mbështetje financiare për OSHC-të. Po kështu Fondi për Çështjet e Mira nga Lotaria Kombëtare, i cili është krijuar me një ligj të veçantë në 2013 ka

²³Të dhëna të siguruara përmes kërkesës përmes informacion drejtuar Yunus Social Business Balkans.

financuar **8 projekte** gjatë periudhës 2015-2017. Në ligj specifikohet që **2.2% e të ardhurave të një kompanie të licensuar duhet ti dedikohet çështjeve të mira.**²⁴

Ndërkaq për biznesin ka disa skema përkatëse në nivel qendror dhe lokal, por dhe nga donatorë të huaj.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) mbështet ndërmarrjet e mesme dhe të vogla përmes disa programesh financimi si: Fondi i Konkurrueshmërisë, Fondi i Ekonomisë Kreative, Fondi në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja “Start-up”, Fondi i Inovacionit. Gjatë 2014-2017 përmes këtyre fondeve në dispozicion janë mbështetur **291 sipërmarrje** me një fond prej **134,685,202 Lekë** (afërsisht 1 milion EUR).²⁵ Në 2015 u lançua fondi “Start-up” nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (ish Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes). Deri në 2017, start-upet mund të përfitonin deri në **300,000 Lekë**, ndërkohë pas 2018 këto kompani kanë mundësi të përfitojnë deri në **500,000 Lekë**. Gjatë 2015-2018 janë financuar **76 start-upe** me një fond prej **25,484,186 Lekë** (afërsisht 205,000 EUR). Buxheti total në dispozicion ka qenë **31,000,000 Lekë** (afërsisht 250,000 EUR).²⁶

²⁴Të dhëna të marra përmes kërkesës për informacion drejtuar Llotarisë Kombëtare, Janar 2018

²⁵Të dhëna të marra përmes kërkesës për informacion drejtuar Agjencisë Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, 2018

²⁶Të dhëna të marra përmes kërkesës për informacion drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Janar 2019

Shërbimi Kombëtar i Punësimit po implementon “Programin e Vetëpunësimit” në bashkëpunim me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, financuar nga qeveria e Zvicrës. Programi konsiston në mbështetjen e të rinjve që dëshirojnë të ndërtojnë biznesin e tyre duke i ofruar trajnim mbi vetëpunësimin, këshillime të vazhdueshme gjatë gjithë fazave të programit dhembështetje financiare.²⁷ Në dy thirrjet e para të manaxhuara nga PNUD janë financuar **84 biznese**, nga të cilat **76 rezultojnë aktive**. Ndërkohë nga thirrja e fundit e manaxhuar nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit në bashkëpunim me PNUD janë financuar **43 biznese**, ku secili start-up merr **500,000 Lekë** në *formën e bazës materiale*.²⁸

Në nivel vendor, Bashkia Tiranë përmes një fondi prej **11,123,782 Lekë** (afërsisht 89,500 EUR) ka mbështetur **31 start-upe** për të rinjtë dhe gratë në nevojë gjatë periudhës 2015 - 2018. Mbështetja financiare mesatare për secilën sipërmarrje është **360,000 Lekë**.²⁹

Fondi European i Investimeve (EIF) dhe institucioni mikrofinanciar (BESA) kanë krijuar një instrument mikrofinanciar për punësimin dhe inovacionin social, i cili ka qëllim që të mbështesë rreth **5,000 sipërmarrje të vogla** në Shqipëri (Varga, 2017).

²⁷Url:<http://aftesi.info/2017/07/25/sipermarresit-e-programit-te-vetepunesimit/>

²⁸Të dhëna të marra përmes kërkesës për informacion drejtuar Shërbimit Kombëtar i Punësimit, Janar 2018

²⁹Të dhëna të marra përmes kërkesës për informacion drejtuar Bashkisë së Tiranës, Janar 2019

Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) është një investitor i rëndësishëm në Shqipëri dhe së bashku me bankën Intesa Sanpaolo në Shqipëri ka financuar **147** ndërmarrje të vogla dhe të mesme të udhëhequra ose në pronësi të grave me një shumë totale prej **2 milion EUR** (afërsisht 250 milion Lekë) gjatë 2 viteve të para të programit (2015-2017). Qëllimi i programit është të përmirësojë aksesin në financa, *krijimin e kredive specifike me interesa të ulëta dhe paketat e produkteve dhe shërbimeve* duke ofruar dhe *zhvillim personal, trajnim & konsulentë* nga ekspertët e BERZH. Marrëveshja e re e nënshkruar nga BERZH dhe Intesa Sanpaolo në kuadër të programit të dytë “Gratë e Ballkanit Perëndimor në Biznes” përfshin një fond prej **5 milion EUR** (afërsisht 620 milion Lekë).³⁰

Përsa i përket mbështetjes ndaj shoqërive të bashkëpunimit bujqësor, Programi i Zhvillimit Rural - Instrumenti i Asistencës së Para-Zgjerimit (IPARD) është një mekanizëm mbështetës i rëndësishëm.

Buxheti në dispozicion për IPARD I ishte rreth **8 milion Euro**, nga të cilat **6 milion Euro** janë kontribut nga Bashkimi Evropian (EU, 2014). Nga të dhënat, shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor nuk kanë përfituar ndonjë fond nga programi IPARD I. Mbështetja ka qenë vetëm në natyrë, ku kanë përfituar vetëm 8 kamionë. Mbështetja e parashikuar për IPARD II është rreth **94 milion EUR** (11.7 miliard Lekë). IPARD II do të mbështesë investimet në *fermat bujqësore,*

³⁰Të dhëna të marra përmes kërkesës për informacion drejtuar Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Janar 2018

investime në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe peshkimit, masa agromjedisore-klimaterike dhe e bujqësisë organike, asistencë teknike, shërbime këshillimore (Ministri e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, 2015). Bazuar në informacionin e dhënë nga përfaqësuesja e Agjencisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, kooperativat do të avantazhohen në këtë thirrje krahasimisht me bizneset.³¹

Në përgjithësi, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme absorbojnë më pak fonde krahasimisht me entitetet e tjera që operojnë si sipërmarrje sociale por dhe krahasuar me shumë shtete të tjera në rajon. Ky problem lind për shkak të mungesës së informacionit dhe kapaciteteve për të aksesuar fondet.

Dy strategji janë hartuar në lidhje me zhvillimin e biznesit respektivisht “Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020” dhe “Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014-2020”. Në Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi njihet nevoja për zhvillimin dhe promovimin e ndërmarrjeve sociale, ku në dy masa përcaktohet:

- a) Dizajnimi dhe implementimi i masave për sipërmarrjen sociale;
- b) Krijimi i kushteve për fuqizimin e punësimit të grave dhe burrave në sektorin e tretë (me fokus ndërmarrjet sociale) (Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, 2015).

Ndërkohë në Strategjinë e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve përcaktohet që duhet të ketë një dialog të vazhdueshëm midis grupeve të interesit

³¹Të dhëna të marra përmes kërkesës përmes informacion drejtuar Agjencisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, 2018.

për të mbështetur zhvillimin e një sërë formash të gjera të biznesit në ndjekje të modeleve të biznesit të qendrueshme dhe përfshirëse. Një nga objektivat kryesore është:

- a) Nxitja e biznesit social, ku parashikohet aprovimi i një pakete ligjore dhe skemave financiare në këtë drejtim si dhe

Sfidat e veprimtarisë së sektorit të sipërmarrjes sociale

Të gjitha studimet e fundit evidentojnë se sfidat kryesore të sipërmarrjeve sociale pavarësisht formës ligjore qoftë organizatë jofitimprurëse, kooperativë, shoqëri kursim krediti apo biznes në Shqipëri janë aksesimi i fondeve dhe skemave financiare në dispozicion, pamundësia për rrjetëzim dhe vështirësia për të penetruar në tregje. Duke qenë se pjesa më e madhe e ndërmarrjeve sociale janë në fazat e para të ciklit të jetës së biznesit mungojnë kapacitetet për të absorbuar këto fonde.

Forma më e përhapur që ka tiparet e sipërmarrjes sociale janë organizatat jofitimprurëse. Vihet re që produktet dhe shërbimet e ofruara nga këto organizata identifikohen kryesisht bazuar në kapacitetet e brendshme të tyre sesa në nevojat e tregut. Kjo vjen pasi këto organizata kanë mungesë kapacitetesh në zhvillimin e planit të biznesit, kërkimin e tregut, krijim kontaktesh dhe rrjetëzim si dhe dizenjimin apo aplikimin e një strategjie e marketingut.

Përsa i përket grupit të targetuar të klientëve, organizatat e konsiderojnë si më të thjeshtë që të

- b) Nxitja e përgjegjësisë sociale të korporatës, një objektiv që synon që ta sjellë dhe biznesin tradicional më pranë komunitetit ku vepron, ashtu siç ka ndodhur tashmë tashmë në korporatat evropiane dhe botërore (Ministri e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, 2015).

shesin shërbimet me pagesë të përfituesit e tyre sesa të krijojnë marrdhënie tregtare me biznesin. Kjo qasje mund të jetë një strategji e mirë për të penetruar në treg, por mbetet afatshkurtër nëse nuk arrihet të targetohen grupe të tjera klientësh apo qoshka të reja tregu. Nga ana tjetër, organizatave jofitimprurëse iu mungon eksperiencia dhe *mendësia sipërmarrëse për të marketuar produktet/shërbimet*. Një nga sfidat kryesore shumë të përmendura është *perceptimi jo i mirë që ka sektori i biznesit për OJF-të*, e cila vjen nga mungesa e ekspozimit dhe kooperimit të dy sektorëve me njëri-tjetrin (Partnerët Shqipëri, 2018).

Kjo mungesë kapacitetesh në këto drejtime bën që produktet dhe shërbimet të mos absorbohen nga tregu siç duhet dhe këto sipërmarrje sociale të varen ende kryesisht nga grantet e donatorëve të huaj dhe vendas më shumë sesa nga shitja e të mirave dhe shërbimeve në treg.

Përsa i përket faktorëve të jashtëm, qoftë organizatat që ofrojnë shërbime/produkte me pagesë por dhe ato të cilat synojnë të ofrojnë në të ardhmen shprehen se *mungon mbështetja institucionale* qoftë përsa i përket mjedisit mundësues ligjor, fiskal dhe atij operativ.

Ndryshimet e shpeshta në mjedisin makro si në sistemin e tatim taksave apo detyrimeve të tjera ndaj shtetit shihet si pengesë për OJFtë që

kryejnë veprimtari ekonomike çka shkakton dhe hezitim në marrjen e riskut për të investuar më tej
(Partnerët Shqipëri, 2018)

Disa nga rekomandimet kryesore mbi eko-sistemin e sipërmarrjeve sociale të bazuara në konsultimet e realizuara

me grupin e sipërmarrjeve sociale dhe të dala nga problematikat e sektorit përmbledhen si më poshtë:

Mjedisi Ligjor

Bazuar në konsultimet e bëra, ekspertët shprehen se një ligj organik, i cili përcakton parimet bazë të funksionimit të ndërmarrjeve sociale duke e zgjeruar spektrin e formave që mund të kualifikohen si sipërmarrje sociale do të krijonte një mjedis mundësues.

Mjedisi mundësues ligjor do të nxisë modelet e inovacionit social, krijimin e vendeve të reja të punës dhe kontribut më të madh në produktin e brendshëm bruto (PBB) të vendit.

- *Qartësimin e përkufizimit të sipërmarrjes sociale* dhe ndërmarrjes sociale duke përcaktuar parimet kryesore në ligj;
- Plotësimin e kuadrit ligjor duke *zgjeruar spektrin me forma të tjera ekzistuese* që funksionojnë si ndërmarrje sociale në përputhje me parimet themelore të sipërmarrjes sociale;
- *Vendosjen e shtysave fiskale* për të mundësuar që ndërmarrjet sociale të japin një kontribut të qëndrueshme në misionin e tyre social;
- Krijimin e *mundësive financuese përtej fondit* në mbështetje të ndërmarrjeve sociale;
- *Përfshirjen e prokurimit social* si pjesë e prokurimit publik bazuar në praktikën evropiane si një mundësi e drejtpërdrejtë për ofrimin e të mirave dhe shërbimeve nga sipërmarrjet sociale;
- *Rishikimin e kushteve shtrënguese* lidhur me kriteret ekonomike dhe sociale të funksionimit të ndërmarrjeve sociale për të mos krijuar një kundër balancë;
- Rishikimin e *penaliteteve* të vendosura për ndërmarrjet sociale;
- *Ndarjen e formave* që ofrojnë shërbime sociale dhe ato që bëjnë integrimin e grupeve të marginalizuara;
- Krijimin e disa *lehtësirave përsa i përket shpërndarjes së fitimit*, ku një pjesë e fitimit të shkojë për anëtarët apo aksionerët duke i inkurajuar kështu sipërmarrësit e rinj socialë të ndërmarrin risk;
- *Krijimi i hapësirave nga pushteti vendor* për të prokuruar shërbimet sociale përmes sipërmarrjeve sociale, por dhe realizimin e partneriteteve direkte në rastin e aktiviteteve që janë specifike dhe mund të kryhet vetëm nga sipërmarrjet sociale.

Mekanizmat mbështetës

- Mekanizmat financiarë të ofruar nga pushteti qëndror dhe ai vendor duhet të shoqërohen me mbështetje *në kapacitete dhe know-how* për ta bërë më të plotë dhe frytdhënës mbështetjen ndaj sipërmarrjes;
- Është e nevojshme që të krijohen mekanizma financiarë dedikuar sipërmarrjes sociale dhe fushave kryesore *nga donatorë vendas dhe të huaj*;
- *Ofrimi i skema të kredive të buta* që vlerësojnë impaktin social si dhe lehtësojnë penetrimin në treg të sipërmarrjeve sociale;
- *Prezantimi i platformave crowdfunding* dhe përdorimi i tyre nga sipërmarrjet sociale si një mjet efektiv i gjetjes së fondeve shtesë.
- Ekziston një nevojë për të organizuar më shumë *workshope informuese, programe trajnimi dhe mentorimi* për organizatat jofitimprurëse që dëshirojnë të krijojnë iniciativa të sipërmarrjes sociale;
- Programet e trajnimit duhet të adresojnë nevoja si *kërkimi i tregut*, ndërtimi i një *plani biznesi*, riformulimi i ideve bazuar *në nevojat e tregut, targetimi i klientëve* si vështirësitë më të mëdha të hasura nga sipërmarrjet sociale;
- Krijimi i *platformave bashkëpunuese* midis sipërmarrjeve sociale dhe biznesit për të rritur njohuritë mbi veprimtarinë e secilit sektor dhe mundësitë e investimeve konkrete.
- Është e rëndësishme që sipërmarrjet sociale të përfshihen në *rrjete në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar* me qëllim që të bëhet një advokim më i mirë i nevojave zhvillimore dhe problematikave që pengojnë zhvillimin e sipërmarrjes sociale;

Promovim i sipërmarrjes sociale

- *Media* duhet të luajë një rol më proaktiv për të promovuar sipërmarrjen sociale dhe benefitet që sjell në ekonomi dhe shoqëri, por dhe sipërmarrësit social duke rritur ndërgjegjësimin dhe edukimin e të rinjve me modele të suksesshme.
- Është e nevojshme që të realizohen më shumë takime, aktivitete midis donatorëve, sektorit të sipërmarrjes sociale, biznesit dhe institucioneve publike me qëllim që të ketë një *bashkërendim të aksioneve* për fuqizimin e sektorit.
- *Universitetet dhe shkollat profesionale* duhet të përditësojnë kurrikulat duke përfshirë sipërmarrjen sociale si një nga fushat më të diskutuara të shekullit të 21^{të}.

Referenca



AMSHC. (2015). *Raport i zgjeruar vjetor 2015*.

AMSHC. (2016). *Raport i zgjeruar vjetor 2016*.

AMSHC. (2017). *Raport i zgjeruar vjetor 2017*.

Babovic, M., Gjurovska, M., Hoxha, J., Jankovic, A., Petrivic, T., Rakin, D., . . . Vidovic, D. (2014). *Studim Strategjik mbi Zhvillimin e Ekonomisë Sociale në Kontekstin e Strategjisë 2020 uropën Juglindore . European Movement in Serbia*.

EU. (2014). *Project EU – IPA 2011 “Support for Agriculture and Rural Development” (SARD) 2014*. Gjetur në <http://www.ipard-like.al/>

Komisioni Evropian. (2015). *Një Hartëzim i Sipërmarrjeve Sociale dhe Eko-sistemit të tyre në Evropë*. Gjetur në <https://ec.europa.eu/social/BlobServlet?docId=12987&langId=en>

Ministri e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. (2015). *Programi i Zhvillimit Rural 2014 - 2020 i Instrumentit të Asistencës së Parazgjerimit (IPA)*.

Ministri e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. (2015). *Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014-2020*.

Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë. (2015). *Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015-2020*.

Partnerët Shqipëri. (2016). *Sfidat dhe Mundësitë për punësimin e grupeve të marginalizuara nga ndërmarrjet sociale*. Tirana.

Partnerët Shqipëri. (2018). *Gatishmëria e OSHCve për Përfshirjen në Aktivitete që Gjenerojnë të Ardhura*.

Varga, E. (2017). *Ekosistemi i Sipërmarrjeve Sociale në Kroaci dhe Ballkanin Perëndimor*. NESsT.